

L I G J
Nr.8751, datë 26.3.2001

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8292, DATË 25.2.1998 “PËR
FORCAT SPECIALE DHE ATO TË NDËRHJRJES SË SHPEJTË”**

Në mbështetje të neneve 78, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr.8292, datë 25.2.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhjrjes së Shpejtë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

“Forcat Speciale dhe ato të Ndërhjrjes së Shpejtë janë struktura të specializuara të Policisë së Shtetit, të krijuara për të realizuar misione ndërhjrjeje dhe sigurimi, ekzekutimi i të cilave kërkon personel të përgatitur dhe të pajisur në mënyrë të posaçme.”

Neni 2

Neni 3 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si vijon:

“Pjesëmarrësve të Forcave Speciale u garantohet fshehtësia e identitetit gjatë ndërhjrjes dhe pas saj.

Fshehtësia e identitetit u garantohet edhe Forcave të Ndërhjrjes së Shpejtë, kur veprojnë në operacione si Forcat Speciale ose në ndihmë të tyre.”

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si vijon:

“Forcat Speciale dhe ato të Ndërhjrjes së Shpejtë janë forca të gatshme të Policisë së Shtetit. Veprimtaria e këtyre forcave shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si vijon:

“Aktivizimi në shërbime i Forcave Speciale dhe i Forcave të Ndërhjrjes së Shpejtë bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në raste të veçanta, kur kërkohet përdorimi masiv i këtyre forcave, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit merr miratimin me shkrim të Ministrit të Rendit Publik.

Forcat Speciale dhe ato të Ndërhjrjes së Shpejtë përdorin armë zjarri, mjete dhe pajisje të posaçme për përmbushjen e detyrave të caktuara nga ky ligj.”

Neni 6

Neni 7 ndryshohet si vijon:

“Detyrat funksionale të Forcave Speciale janë:
 - Lirimi i pengjeve në kushtet e sigurisë më të lartë.
 - Ndërhyrja kryesisht në mjedise urbane për ndalimin, arrestimin, neutralizimin e personave pjesëtarë të organizatave terroriste e kriminale, të bandave të armatosura, si dhe të çdo personi tjetër të armatosur ose që ka kryer një krim me armë.
 - Ndihma ndaj popullatës në raste fatkeqësish të rënda natyrore e aksidentale, vetëm kur kjo është mundësia e vetme për shpëtimin e jetës së njerëzve.”

Neni 7

Neni 8 ndryshohet si vijon:
 “Detyrat funksionale të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë janë:
 - Sigurimi i rendit gjatë veprimtarive masive publike, në raste fatkeqësish të rënda natyrore dhe fatkeqësish të tjera, të cilat mund të shoqërohen me prishje të rendit.
 - Sigurimi i rendit në akset rrugore kombëtare në rastet kur në to ka veprimtari të bandave e grupeve të armatosura.
 - Marrja në ruajtje e objekteve të rëndësishme shtetërore dhe social-ekonomike, kur ka të dhëna për sulme me armë ose pa armë ndaj tyre, në qoftë se forcat e caktuara për këtë qëllim nuk janë në gjendje t’i ruajnë.
 - Shoqërimi i personave të rrezikshëm në gjykata, burgje, dhoma paraburgimi, kur ka të dhëna për përpjekje për lirin e tyre.
 - Ndërhyrja për rivendosjen e rendit të prishur nga akte të rënda dhune në të gjitha mjediset publike, kur forcat e policisë vendore nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë.
 - Ndërhyrja për ndalimin, arrestimin e personave të shpallur në kërkim ose që ndiqen nga policia, grupeve kriminale, bandave të armatosura, kryesisht në zona rurale, kur policia vendore nuk është në gjendje t’i kryejë vetë këto.
 - Ndërhyrja për rivendosjen e gjendjes normale në burgje e dhoma paraburgimi në raste rebelimi masiv të të burgosurve.
 - Ndërhyrja e operacioneve në ndihmë të popullatës në rastet e fatkeqësive të rënda natyrore dhe fatkeqësive të tjera.”

Neni 8

Neni 10 ndryshohet si vijon:
 “Pranimi në Forcat Speciale dhe në ato të Ndërhyrjes së Shpejtë bëhet sipas kriterëve të përcaktura në ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe sipas kriterëve të veçanta të përcaktuara në akte nënligjore.”

Neni 9

Neni 12 shfuqizohet.

Neni 10

Neni 13 ndryshohet si vijon:
 “Punonjësve të Forcave Speciale dhe atyre të Ndërhyrjes së Shpejtë, kur kërcënohen për shkak të detyrës, u sigurohet mbrojtje e veçantë e jetës, familjes dhe pronës, në përputhje me kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 11

Kudo ku në ligj përdoren fjalët “Ministria e Brendshme” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Rendit Publik”.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2952, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani